



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 132, datë 24.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT SI DHE GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 3, 5, 6, RRASHBULL DHE SUKTH, BASHKIA Durrës

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit Këshillit Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, si dhe të raportit dhe relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :



1. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative 3, 5, 6, Rrashbull dhe Sukth, Bashkia Durrës, bashkëlidhur.
2. Miratimin e raportit të Komisionit të Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Njësinë Administrative 3, 5, 6, Rrashbull dhe Sukth, Bashkia Durrës, bashkëlidhur.
3. Miratimin e listës me 1 (një) banesë të subjektit përfitues nga programi i rindërtimit nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja individuale në Njësinë Administrative Nr. 3, sipas ankesit 1, bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Miratimin e listës me 3 (tre) banesa të subjekteve përfituese nga programi i rindërtimit nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja individuale në Njësinë Administrative Nr. 5, sipas ankesit 2, bashkëlidhur dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Miratimin e rikonstruksionit të 2 (dy) banesave të subjekteve përfituese nga programi i grantit të rikonstruksionit, Njësia Administrative nr.5, sipas ekspertizës së thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas ankesit 2, bashkëlidhur dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Miratimin e listës me 2 (dy) banesa të subjekteve përfituese nga programi i rindërtimit, nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja individuale në Njësinë Administrative nr.6, sipas ankesit 3, bashkëlidhur dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Miratimin e listës me 1 (një) banesë të subjektit përfitues nga programi i rindërtimit nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja individuale në Njësinë Administrative Rrashbull, sipas ankesit 4 , bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Miratimin e listës me 2 (dy) banesa të subjekteve përfituese nga programi i rindërtimit nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja individuale në Njësinë Administrative Sukth , sipas ankesit 5, bashkëlidhur dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave tek Njësia Zbatuese sipas Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”.

10. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtoria e BPSHV dhe Emergjencave Civile.

11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.12.2020

A DURRËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Nr. 9565/Prot.
57

Durrës, më 23.12 . 2020



RAPORT

KOMISIONI I POSAÇËM

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT
NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR 3, 5, 6, RRASHIBULL, SUKTH BASHKISË
DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË
RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA
NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, si dhe Komisioni i Posaçëm , i ngritur me Urdhërin nr.164, datë 26.05.2020 i ndryshuar me urdhërin ??? datë 06.07 2020 do të vlerësojë kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve të aplikuesve për banesat individuale me nivel dëmi DS4-DS5 në Bashkinë Durrës”,

Ju paraqesim relacionin si më poshtë:

Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes i ngritur me urdhër nr. 108, datë 12.03.2020 të Zëvendëskryetarit të Bashkisë, për shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të

aplikuesve për banesat individuale me nivel dëmi DS4 dhe DS5 në Njësitë Administrative Nr 3, 5, 6, Rrashbull, Sukth.

Zyra e posaçme ka hedhur të dhënat e administruara si dhe klasifikimin e Aplikantëve për përfitimin e grantit të rindërtimit, rikonstruksionit dhe rimëkëmbjes në Bashkinë Durrës, për banesat individuale të Njësiave Administrative Nr. 3, 5, 6, Rrashbull, Sukth.

Komisioni i posacëm , i ngritur me Urdhërin nr.164, datë 26.05.2020 i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020 do të vlerësojë kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve të aplikuesve për banesat individuale me nivel dëmi DS4-DS5 në Bashkinë Durrës”,

Zyra e posaçme me Raportin i është drejtuar Komisionit të Posacëm për listën përfituese për Njësitë Administrative Nr 3, 5, 6, Rrashbull, Sukth, që janë kualifikuar në programin e granteve të rindërtimit dhe projekteve model. Në raport Zyra e Posacme e Rindërtimit na ka përcjellë listën e subjekteve përfituese nga programi i rindërtimit, nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja individuale sipas aneksit bashkalidhur si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Raporti nr. 9565/50 prot. datë 27.11.2020 për Njësinë Administrative Nr.3 janë 1 subjekte përfituese për grantin e rindërtimit.

Raporti nr. 9565/53 prot. datë 21.12.2020 për Njësinë Administrative Nr.5 janë 3 subjekte përfituese për grantin e rindërtimit dhe 2 subjekte përfituese për grantin e rikonstruksionit.

Raporti nr. 9565/52 prot. datë 21.12.2020 për Njësinë Administrative Nr.6 është 2 subjekte përfituese për grantin e rindërtimit.

Raporti nr. 9565/54 prot. datë 22.12.2020 për Njësinë Administrative Rrashbull janë 1 subjekte përfituese për grantin e rindërtimit

Raporti nr. 9565/51 prot. datë 27.11.2020 për Njësinë Administrative Sukth janë 2 subjekte përfituese për grantin e rindërtimit.

Grupi i punës, ngritur me urdhërin e zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 164 Komisioni i Posacëm, datë 26.05.2020: i ndryshuar.

Kryetar i komisionit të posacëm: Florian Tahiri

Anëtar :Ermal Lulo



Andri Cerri,
Diana Mandia,
Klara Agasi,
Edvin Hysi,
Afroviti Mantlaj,
Myslym Hasanaj
Erjon Meka
Serjan Mazreku
Albert Bukaci
Rrapo Osmani

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3

Nr.	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	KUALIFIKOHET
1	45737	BAJRAM	HYSNI	ISTREFI	PRISHJE	PO

ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

Nr.	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	KUALIFIKOHET
1	44329	FATMIR	XHEVDET	TROPLINI	PO	PRISHJE
2	37228	SOTIAN	NIKOLLA	SHKOZA	PO	RIFORCIM
3	59614	MARIANTHI	JORGO	KOCO	PO	PRISHJE
4	51262	NAIM	IDRIZ	MANDRI	PO	RIFORCIM
5	53092	XHEVDET	RAMADAN	DULE	PO	PRISHJE



ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.6

Nr.	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	KUALIFIKOHET
1	15940	DEMIR	PASHO	KAJO	PRISHUR ME P.V. IMTV	PO
2	15732	EDUART	ABAS	MUHO	PRISHUR ME P.V. IMTV	PO

PRISHUR

ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL

NR	NR APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	13628	ESAT	BEJDO	XHANARI	PO	PRISHJE



ANEKSI 5. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA GRANTI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	KONKLZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	44352	SHPËTIM	FIQËRI	ÇAMI	PRISHJE	PO
2	52402	GEZIM	AHMET	SABLI	PRISHJE	PO

12/01/2024




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 1103 prot.
16

Durrës, më 30.12.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.132 datë 24.12.2020:

Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit si dhe grantit të rikonstruksionit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2020, në njësitë administrative nr. 3, 5, 6, rashbull dhe Sukth, Bashkia Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

